VENDIM
Nr.68, datë 17.10.2006

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES ENERGJISË ELEKTRIKE PËR SHOQËRINË "WONDER POWER" SHA PËR VITIN 2007

Në mbështetje të neneve 9 dhe nenit 26, pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", me ndryshime, si dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.26, datë 13.5.2004 "Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", me ndryshimet përkatëse, neni 11 germa A, Bordi i Komisionerëve të ERE–s, në mbledhjen e tij të datës 17.10.2006, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria "Wonder Power" sh.a., për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, për vitin 2007,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit, për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për shoqërinë "Wonder Power" sh.a. për vitin 2007.
2. Ngarkohet Departamenti i Tarifave dhe Çmimeve për shqyrtimin e këtij aplikimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta